

## Neni 18

### Organizimi dhe administrimi i institucioneve të rivlerësimit

1. Institucionet e rivlerësimit kanë personel dhe pajisjet e nevojshme për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga ky ligj. Struktura organizative dhe klasifikimi i pagave për personelin e institucioneve të rivlerësimit miratohen nga Kuvendi, me propozimin e institucionit përkatës. Personeli i institucioneve të rivlerësimit përbëhet nga njësia e shërbimit ligjor dhe punonjësit administrativë.
2. Kolegji i Apelit ndihmohet edhe nga strukturat mbështetëse të Gjykatës Kushtetuese.
3. Marrëdhënia e punësimit me punonjësit e institucioneve të rivlerësimit rregullohet sipas këtij ligji dhe Kodit të Punës.
4. Autoriteti përgjegjës për pranimin në punë të punonjësve është komiteti ad hoc që krijohet pranë çdo institucioni. Ai përbëhet nga 2 anëtarë të Komisionit ose të Kolegjit të Apelit, përkatësisht sipas rastit, të zgjedhur më short, si dhe nga Komisioneri Publik më i vjetër në moshë. Për pranimin në punë të punonjësve pranë komisionerëve publikë, komiteti ad hoc përbëhet nga 2 Komisionerët Publikë dhe nga gjyqtari më i vjetër në moshë i Kolegjit të Apelit.

## Neni 22

### Njësia e shërbimit ligjor

1. Pranë Komisionit dhe Kolegjit të Apelit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor që ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, në varësi të mbledhjes së komisionerëve ose gjyqtarëve.
2. Procesi i rekrutimit bazohet në një procedurë të hapur dhe transparente për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga komiteti ad hoc i krijuar në institucionin përkatës.
3. Këshilltari ligjor është shtetasi shqiptar, i cili plotëson kriteret e mëposhtme:
  - a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
  - b) ka pasur një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet;
  - c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;
  - ç) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
  - d) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

4. Këshilltari ekonomik është shtetasi shqiptar, i cili përmbush kriteret e mëposhtme:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkencë ekonomike, matematike ose në drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për shkencë ekonomike, matematikë ose drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

b) ka pasur një përvojë pune në sektorin financiar jo më pak se 7 vjet;

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;

ç) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;

d) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;